



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:006659

Datë: 29.01.2024

Numri i dokumentit: 05254537

P.nr.122/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e çështjes Laura Hoti Statovci , duke vendosur lidhur me pranimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me numër Nd.606/23 të datës 28.12.2020, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.6038/2019 e datës 20.01.2020, kundër të akuzuarit A. V. , për shkak të veprës penale *Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së*, jashtë seancës konform nenit 229 të KPPRK-së, dhe nenit 2 lidhur me nenin 31 të Ligjit nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), Gjykata më datën 10.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I.** APROVOHET marrëveshja nr. Nd.606/23 të datës 28.12.2020, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të akuzuarit A. V. ne njëerën ane dhe të dëmtuarve përfaqësuesve të K...-it në anën tjetër.
- II.** HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë , PP.II.nr.6038/2019 e datës 20.01.2020 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarit A.V. për shkak të veprës penale *Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së*, për shkak se të akuzuarit dhe të dëmtuarit, kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën , PP.II.nr.6038/2019 e datës 20.01.2020, ka ngritur aktakuzë kundër kundër të akuzuarit A. V. për shkak të veprës penale *Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së*.

Gjykata me datë 05.10.2023 ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale dhe me akordimin e palëve në procedurë e duke vepruar konform nenit 8 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendrën për Ndërmjetësim.

Me datë 28.12.2023 në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë është arritur marrëveshja Nd.606/23 në mes të palëve në procedurë. Andaj, gjykata duke vepruar konform

dispozitave të nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Konform nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësimin, nga data e pranimit nga gjykata, përkatësisht nga data 10.01.2024, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 229 të KPPRK-së dhe nenin 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.122/20 datë 10.01.2024

G j y q t a r j a

Laura Hoti Statovci

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa dhe e njëjta do ta ketë Fuqinë e titullit ekzekutiv.